

PHILIPS

Orë radio

3000 Series

R3306



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Siguria	2
	Njoftim	2
2	Ora radio	3
	Hyrje	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje e orës radio	3
3	Fillimi	4
	Instalimi i baterive	4
	Lidhja e energjisë	4
	Vendosja e orës	4
4	Dëgjimi i radios FM	5
	Kalimi nëpër stacionet FM	5
	Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM	5
	Ruajtja manualisht e stacioneve të radios FM	5
	Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur	5
	Rregullimi i volumit	5
5	Veçori të tjera	6
	Vendosja e orës së alarmit	6
	Vendosja e kohëmatësit të gjumit	6
	Rregullimi i ndriçimit të ekranit	6
6	Informacione për produktin	7
7	Zgjidhja e problemeve	7

1 E rëndësishme

Siguria

- Lexoni këto udhëzime.
- Vëruni veshin të gjitha paralajmërimeve.
- Ndiqni të gjitha udhëzimet.
- Mos bllokoni asnjë hapësirë ajrimi. Instalohen sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie, si për shembull pranë radiatorëve, rrugëdaljeve të ngrohjes, sobave ose pajisjeve të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- Mbrojeni kordonin e energjisë në mënyrë që të mos shkelet ose kafshohet, sidomos pranë spinave, prizave dhe në pikën ku dalin nga ora radio.
- Përdorni vetëm pjesë/aksesorë që janë specifikuar nga prodhuesi.
- Shkëputeni pajisjen kur ka stuhi ose kur nuk përdoret për periudha të gjata kohe.
- Vetëm personeli i kualifikuar duhet t'i bëjë riparime. Riparimet duhen bërë kur pajisja është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kur kordoni i energjisë ose spina është dëmtuar, kur janë derdhur lëngje ose kanë rënë objekte brenda pajisjes, kur pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, kur nuk punon normalisht ose kur është rrëzuar.
- KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë – Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të orës radio:
 - Montojini të gjitha bateritë si duhet, + dhe - siç janë shënuar në aparat.
 - Hiqini bateritë kur aparati nuk përdoret për kohë të gjatë.
 - Bateria nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të larta, si për shembull ndaj dritë së diellit, zjarrit ose të ngjashme.
- Kjo orë radio nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi orën radio (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
- Aty ku spina e energjisë të adaptorit direkt Plug-in përdoret si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.

Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur produktin. Këtu TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.



Ky produkt u përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio.



Ky produkt është bërë dhe është prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol do të thotë se produkti nuk duhet të hidhet bashkë me mbetjet shtëpiake, por duhet të çohet në një pikë të përshtatshme grumbullimi për riciklim. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e asgjësoni asnjëherë produktin dhe bateritë e rikarikueshme me mbetjet normale shtëpiake. Asgjësimi i duhur i produkteve të vjetra dhe baterive të rikarikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e veçantë të mbetjeve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

2 Ora radio

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Hyrje


Me këtë orë radio, ju

- mund të dëgjoni radio FM
- mund të vendosni dy alarme që të bien në orare të ndryshme.

Çfarë ka në kuti


Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- Adaptor i energjisë
- Manuali i përdorimit
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë
- Garancia



Përmbledhje e orës radio

- ① 
 - Ndizeni ose kalojeni në gjendje joaktive.
- ② **PRESET / SET TIME**
 - Ruani stacionet e radios në memorie.
 - Zgjidhni një stacion radioje të ruajtur paraprakisht.
 - Vendosni orën.
- ③ **HR / MIN / ◀TUN ▶**
 - Vendosni orën dhe minutat.
 - Shkoni në stacione radioje FM.
- ④ **SNOOZE / BRIGHTNESS**
 - Shtyni alarmin.
 - Rregulloni ndriçimin e ekranit.
- ⑤ **Display panel**
 - Shfaqni statusin aktual.
- ⑥ **SLEEP / SCAN**
 - Vendosni kohëmatësin e gjumit.
 - Skanoni dhe ruani automatikisht stacionet e radios.
- ⑦ **AL1 / AL2 / – VOL +**
 - Vendosni alarmin.
 - Rregulloni volumnin.



3 Fillimi

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.

Instalimi i baterive


Bateritë mund të ruajnë vetëm parametrat për orën dhe alarmin.



Kujdes

- Rrezik shpërthimi! Mbajini bateritë larg nga nxehtësia, drita e diellit ose zjarri. Asnjëherë mos i hidhni bateritë në zjarr.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.
- Mos i përzieni llojet e ndryshme të baterive: p.sh. alkaline me zink karboni. Përdorni vetëm bateri të të njëjtit lloj për aparatin.

Vendosni 2 bateri AAA (nuk janë dhënë) me polaritetin e duhur (+/-) siç tregohet në figurë.



Lidhja e energjisë



Kujdes


- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë të përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë orës radio.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur e hiqni kordonin e energjisë, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Asnjëherë mos tërhiqni kordonin.



Shënim

- Etiketa e të dhënave ndodhet poshtë orës radio.

Futeni adaptorin e energjisë te priza në mur.



Vendosja e orës



Shënim

- Orën mund ta vendosni vetëm kur pajisja është në gjendje joaktive.

- 1 Kur ora është në gjendje joaktive, mbani shtypur **SET TIME** për 2 sekonda.
- 2 Shtypni **HR** për të vendosur orën dhe pastaj **MIN** për të vendosur minutat, më pas shtypni **SET TIME** për të konfirmuar.
↳ Ora është vendosur.

4 Dëgjimi i radios FM



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.

Ruajtja manualisht e stacioneve të radios FM

- 1 Te modaliteti i tunerit FM, shkoni te një stacion radioje FM.
- 2 Mbani shtypur **PRESET** për 2 sekonda për të aktivizuar modalitetin e programimit.
↳ Numri i ruajtur fillon të pulsojë.
- 3 Shtypni vazhdimisht **◀TUN▶** për të zgjedhur një numër.
- 4 Shtypni përsëri **PRESET** për të konfirmuar.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri në 4 për të ruajtur stacione radioje FM të tjera.



Këshillë

- Për ta fshirë një stacion të ruajtur, ruani një stacion tjetër në vend të tij.

Zgjedhja e një stacioni radioje të ruajtur

Opsioni A:

Në modalitetin e kërkimit FM, shtypni vazhdimisht **PRESET** për të zgjedhur një numër të ruajtur.

Opsioni B:

- 1 Te modaliteti i tunerit FM, shtypni **PRESET**.
- 2 Shtypni **◀TUN▶** për të zgjedhur një stacion radioje të ruajtur paraprakisht.

Rregullimi i volumnit

Ndërkohë që dëgjoni, shtypni **– VOL +** për të rregulluar volumnin.



Shënim

- Mbajeni orën radio larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Për marrje më të mirë të sinjalit, shtrijeni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e FM antenës.

Kalimi nëpër stacionet FM

- 1 Shtypni për ta ndezur orën radio.
- 2 Mbani shtypur **◀TUN▶** për 2 sekonda.
Ora radio shkon automatikisht në një stacion Clock radio me sinjal të fortë.
- 3 Përsëritni hapin 2 për të shkuar në më shumë stacione radioje.

Për të shkuar manualisht në një stacion:

Shtypni vazhdimisht **◀TUN▶** për të zgjedhur një frekuencë.



Shënim

- Rrjeti i kërkimit të orës radio është 50 KHz, frekuenca e radios në panelin e ekranit rritet me 0,1 MHz kur shtypni **◀TUN▶** dy herë.

Ruajtja automatikisht e stacioneve të radios FM

Në modalitetin e kërkimit FM, mbani shtypur **SCAN** për më shumë se 2 sekonda.

↳ Pajisja ruan automatikisht të gjitha stacionet e radiove FM të disponueshme dhe transmeton stacionin e parë.

5 Veçori të tjera

Vendosja e orës së alarmit

Vendosja e alarmit



Shënim

- Alarmin mund ta vendosni vetëm kur pajisja është në gjendje joaktive.
- Sigurohuni që ta keni vendosur orën si duhet.

- 1 Në modalitetin në pritje, mbani shtypur **AL1** ose **AL2** për 2 sekonda për të vendosur orën e alarmit.
- 2 Shtypni **HR** për të vendosur orën dhe **MIN** për të vendosur minutat, më pas shtypni **AL1** ose **AL2** për të konfirmuar.



Këshillë

- Pajisja del nga modaliteti i vendosjes së alarmit kur nuk bëhet asnjë veprim për 10 sekonda.

Zgjidhni burimin e alarmit

Mund të zgjidhni radion FM ose sinjalizuesin si burim alarmi duke shtypur **AL1** ose **AL2** kur pajisja është në gjendje joaktive.

↳ Ikona përkatëse e alarmit ndizet.

Aktivizimi/çaktivizimi i alarmit

Shtypni vazhdimisht **AL1** ose **AL2** për të aktivizuar ose çaktivizuar kohëmatësin e alarmit.

↳ Nëse kohëmatësi i alarmit është aktivizuar, treguesi i alarmit ndizet.

↳ Nëse kohëmatësi i alarmit është çaktivizuar, treguesi i alarmit fiket.

↳ Alarmi bie përsëri të nesërmen.

↳ Për ta ndaluar alarmin, shtypni **AL1** ose **AL2**.

Shtypni alarmin

Kur bie alarmi, shtypni **SNOOZE**.

↳ Alarmi shtyhet dhe bie përsëri 9 minuta më vonë.

Vendosja e kohëmatësit të gjumit


Kjo orë radio mund të kalojë automatikisht në gjendje joaktive pas një periudhe të caktuar.

- Shtypni vazhdimisht **SLEEP** për të zgjedhur një periudhë (në minuta).

↳ Ora radio kalon automatikisht në gjendje joaktive pas periudhës së caktuar.

Për ta çaktivizuar kohëmatësin e gjumit:

- Shtypni vazhdimisht **SLEEP** derisa të shfaqet **[OFF]** (fikur).



Rregullimi i ndriçimit të ekranit

Shtypni vazhdimisht **BRIGHTNESS** për të zgjedhur nivele të ndryshme ndriçimi:

- I lartë
- Mesatar
- I ulët

6 Informacione për produktin

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Amplifikatori

Fuqia nominale output	400 mW RMS
-----------------------	------------

Kërkimi (FM)

Rrezja e kërkimit	87,5-108 MHz
Rrjeti i kërkimit	50 KHz
Ndjeshmëria - Mono, 26 dB S/N Ratio	< 22 dBf
Shtrembërimi total harmonik	< 3 %
Raporti sinjal-zhurmë	> 50 dBA

Informacione të përgjithshme

Energjia AC (adaptor i energjisë)	Marka: Philips Modeli: AS030-050-EE060 Hyryja: 100-240 V~ 50/60 Hz; 0,15 A Dalja: 5 V $\pm$ 0,6 A
Konsumi i energjisë gjatë punimit	< 3 W
Konsumi i energjisë në gjendje joaktive	< 1 W
Përmasat (Gje x La x Tra)	186 x 96 x 65 mm
Pesha (njësia kryesore)	296 g

7 Zgjidhja e problemeve

Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni vetë pajisjen. Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonit shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips www.philips.com/support. Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që spina e energjisë AC të pajisjes të jetë lidhur si duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumnin.

Pajisja nuk përgjigjet.

- Shkëputeni dhe lidheni përsëri spinën e energjisë AC, më pas ndizeni pajisjen përsëri.

Marrje e dobët e sinjalit

- Mbajeni orën radio larg nga pajisjet e tjera elektronike për të shmangur interferencat e radios.
- Zgjateni plotësisht dhe lëvizeni pozicionin e antenës.

Alarmi nuk punon

- Vendoseni si duhet orën/alarmin.

Ora/alarmi fshihet

- Është ndërprerë energjia ose është shkëputur kordoni i energjisë.
- Vendoseni përsëri orën/alarmin.
- Ndërroni bateritë.



2021 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Të dhënat teknike mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

